REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 153/17
Datë/Datum. 07.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: **"Trepça - ndermarrje ne administrimin e AKP".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen nr. **153/17**, parashtruar nga OE , **„ Almakos Group"shpk, - Prishtinë**		
Datë:	**07.06.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "***Furnizim me pjese rezerv per ngarkuesit nëntokësorë ST 2 D***", me nr. të Prokurimit: ST **17/067/121**. të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Trepça - Ndermarrje në administrimin e AKP-së"**, me përgjigjejet ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **„ Almakos Group"shpk, - Prishtinë,** me nr. **153/17,** të datës **24.05.2017.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues – teknik, lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **Trepça - ndermarrje ne administrimin e AKP"**
- Panelit Shqyrtues - **"OSHP".**
- OE - ankues - **„ Almakos Group"shpk, - Prishtinë**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		30.05.2017		05.06.2017		07.06.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **24.05.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 153/**17**, e parashtruar nga OE **„Almakos Group"shpk, - Prishtinë**, kundër AK – Trepça - ndermarrje ne administrimin e AKP, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "***Furnizim me pjese rezerv per ngarkuesit nëntokësorë ST 2 D"***, me nr. të Prokurimit: ST **17/067/121**.
Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – Trepça - ndermarrje ne administrimin e AKP.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues , „Almakos Group"shpk, - Prishtinë , me seli në Prizren.

Pikat e Ankesës nga OE **„Almakos Group" shpk, - Prishtinë** , nga Prizren, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*
Neni 7.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne baze te ligjit per prokurim publik te republikes se kosoves nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Ne nuk kemi pranuar letren standarde per eleminim nga tenderi nga ana e autoritetit kontraktues . Ne jemi njoftuar per dhenje te kontrates vetem permes platformes elektronike e-prokurimi me daten 11.05.2017.

Dhe ne nuk e dijme arsyen pse neve nuk na eshte dhene kontrata edhe pse kemi qene me t e lire per 6,167.72 euro, ku edhe ne vitet e kaluara per pjese rezerve te ngjashme ne kemi furnizuar rreth 5 – 6 vite dhe nuk kemi pasur asnje reklamacion nga ana e Autoritetit kontraktues.

Me d aten 22.05.2017, kemi bere kerkes per qasje ne dosje te tenderit te operatorit ekonomik fitues "Segment Kosova" dhe me date 23.05.2017, kemi marr pjese ne qasje te dosjes s e tenderit;

Gjate shikimit te dosjes s e tenderit kemi vene re se OE fitues "Segment Kosova" ka certefikate te prodhuesit ISO 9001:2008, me afat t e skaduar te viti 2012.

Nga Autoriteti Kontraktues eshte kerkuar Autorizimi dhe certefikata ISO nga Prodhuesi Atlas Copco, ku ne kete rast eshte favoricuar vetem nje prodhues,

Ne baze te kesaj eshte shkelur neni 7 Barazia ne trajtim jo / diskriminim Ne ju informojme se ne jemi distributor i autorizuar nga prodhuesi Vikay, poashtu kemi edhe certefikaten ISO. Andaj ne kerkojme qe Autoriteti Kontraktues qe te kthej lenden ne ri-vleresim. *Demet material:*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	30.04.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	furnizim/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	18.04.2017
Data e hapjes së ofertave	18.04.2017
Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës sipas pershkrimit ne njoftim.	11.05.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net. 2. Operatori ekonomik duhet të dorëzoj dëshmi lidhur me nenin 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4]. 3. Operatori ekonomik duhet të deshmon se nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. [Neni 65 paragrafi 4, nënparagrafi 4.8].	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:** 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneksi 2 - kërkohet të dorzohet nga çdo ofertues me rastin e dorzimit të ofertëstenderit të tij. 2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. Ky dokument duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para nënshkrimit të kontratës. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet]. 3. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore. Ky dokument duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para nënshkrimit të kontratës. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet].
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e vet të	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:** 1. Kopje e certifikatës të biznesit. 2. Kopje e certifikatës për TVSH. 3. Kopje e regjistrimit të numrit fiskal. 4. Autorizimin nga Atlas Copco.

themelimit. 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin për TVSH. 3. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin për numrin fiskal. 4. OE duhet të dëshmoj se është autorizuar nga Atlas Copco për shitjen e pjesëve origjinale të Prodhuesit Atlas Copco.	
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	**Dëshmia e kërkuar dokumentare**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Ofertuesi duhet të deshmoj perputhshmërinë e produkteve të ofruara me standardin ISO për kualitet.	**Dëshmia e kërkuar dokumentare** 1. Kopje e certifikatës për kualitet ISO 9001: 2008 (ISO 9001: 2015)

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"CMC - Ekokon"shpk	Prishtinë	49 288, 63 €	JO
2.	NPT"A -Com"	Prishtinë	45 409, 90 €	JO
3.	"Segment Kosova"	Prishtinë	49 438, 00 €	JO
4.	"Almakos"shpk	Prishtinë	43 270,28 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 18.04.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katër (4) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Isak Meholli
- - Anëtar i komisionit - Zenel Gashi
- - Anëtar i komisionit – Naser Bajrami

Data e mbarimit të vlerësimit: 03.05.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....24.05.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni pas vleresimit te tendereve te pranuar te cilet ishin 4(kater). Tre prej tyre jane te pergjegjeshem OE" CMC - Ekokon shpk, NPT A-Com", "Almakos –Group"shpk, nuk ka dorezuar Autorizimin nga Atlas Copco dhe Certefikaten ISO per kualitet. Ndersa OE "Segment Kosova" shpk, ka dorezuar autorizimin nga Atlas Copco dhe certefikaten ISO per kualitet dhe per kete arsye komisioni eshte i mendimit qe me kontrate te shperblehet OE "Segment Kosova"shpk, me cmimin e ofruar prej 49.438,00.

Analiza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarim hyres: Autoriteti Kontraktues - "Trepça - Ndermarrja nën administrimin e AKP-së", gjat këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: **"Almakos- Group"**, ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënje të kontratës.

Kunder të njejtit njoftim parashtruesi i ankesës sipas përshkrimit më datën **23.05.2017**, paraqet kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, përmes shkresës elektronike – e mailit, me pretendimet ankimore se nuk është respektuar neni **7** i LPP-së. AK – "Treçca – Ndermarrja nën administerimin e AKP-së", të nesermën më datën **24.05.2017**, poashtu përmes shkresës elektronike i përgjigjet parashtruesit të ankesës OE "Almakos – Group", dhe jep sqarim se e njejta kërkesë nuk mundë të shqyrtohet pasi që është parashtruar pas afatit të paraparë me rregulloren për paraqitje të kërkesës tek AK.

Sqarimi nr.1. Fillimisht sqarojmë se AK, me rastin e përgjigjes kundrejt kërkesës për ri-shqyrtim të lartë përmendur, nuk ka respektuar në tërësi nenin **108/A**, të LPP-së, dhe paragrafin **8.2**, të nenit **8**, të rregullave për paraqitje të kërkesës për ri shqyrtim pranë AK-së, legjislacinon sekondar i KRPP-së, ku shprehimisht thuhet : "...vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i komunikohet me shkrim, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara nëse ka".

- Megjithatë parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankesë pohon se më datën **11.05.2017**, përmes platformes elektronike e-prokurimi është njoftuar për dhënjen e kontratës, poashtu edhe njoftimi për dhënje (kopja fizike) përmban datën **11.05.2017**. Ndësa data e kopjes së shkresës elektronike, ku sipaspërshkrimit është paraqitur kerkesa për ri-shqyrtim përmban datën. **24.04.2017**, (pas 13 ditesh).

Pra sipas asaj që u përshkrua më larte konkretisht sipas nenit **5**, të LPP-së në fuqi, rezulton që kërkesa për ri-shqyrtim është paraqitur tek AK, jashte afatit ligjor, gjegjësisht neni **108/A**, par. **3.2**, poashtu i LPP-së, dhe nenit neni **4**, par **1**, i rregullave për paraqitje të kërkesës për ri shqyrtim pranë AK-së, shprehimisht thot: *"në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me **vendimin për dhënie të një kontratë** ose të një konkursi të projektimit, **brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës** ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit **<u>që i është dërguar ankuesit</u>**".* Për më tepër neni 109, paragrafi 1, i LPP-së, në fuqi, sqaron proceduren fillestare dhe afatet e dorezimit të ankesës në OSHP, "*...Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarreveshjës në përputhje me nenin 108/A".*

Përfundimishtë sqarojm se neni **105**, paragrafi **2.6**, i LPP-së, (Kompetencat e OSHP-së)

shprehimisht thot: *"**nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët**, dhe deri më tani të lejuar nga ky ligj, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit".* Ndëkaq sipas shkresave të lëndës së AK-së, rezulton që më datën 24.05.2017 AK, të ketë hyrë në marëdhënje të deturimeve, sipas kopjes së kontratës pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në raport propozon panelin shqyrtues që ta lë në fuqi vendimin e AK-se, "Trepça - Ndërmarrje nën administrimin e AKP-së", për dhënje të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "***Furnizim me pjesë rezerv për ngarkuesit nëntokësorë ST 2 D"***, me nr. të Prokurimit: ST **17/067/121**, pasi që AK, ka lidh kontratë, tanimë, ndërsa ankesa e OE **„Almakos Group" shpk**, - Prishtinë, të **hudhet si e pa lejuar.**